



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 43
Prishtinë, më 15. 09. 2009, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq,
Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi dhe
Shpresa Murati.

Mungoi: Naim Rustemi (Ishte në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës).

Mbledhjen e mbikëqyrën: përfaqësuesi i OSBE-së dhe Rrezarta Ahmeti – KDI.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, zyrtar i lartë dhe
Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Kryetari konstatoi se *ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë*

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Dinamika e realizimit të Raportit të Progresit nga Komisioni,
- 3 Shqyrtimi i kërkesës së banjës së Kllokotit dhe të Konfederatës Sindikale,
- 4 Të ndryshme:
(a) Njoftim për takimin e kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Dinamika e realizimit të Raportit të Progresit nga Komisioni

Kryetari - I njoftoi anëtarët me dinamikën e Raportit të Progresit të Veprimit - Sfidat e Progresit të Komisionit Evropian lidhur me detyrimet që dalin me këtë plan. Në vazhdim tha se sipas pikës 24-3 të Plani të Veprimit - Komisioni do të kërkojë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës mjete buxhetore shtesë për funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Komisioni u pajtua të fillohet me plotësimin dhe ndryshimi i Ligjit për Avokat të Popullit. Në këtë kontekst u kërkuar nga Ibrahim Makolli ta hartojë Raportin për ligjet e miratuara, si projektligje në procedim, për të parë a janë në përputhje me dokumentet për të drejtat e njeriut sipas pikës -36 -2-, të përgatisë raporte të veçanta vjetore, që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me ligjet e miratuara në Kuvend.

Z. Ibrahim Makolli – Tha se këto raporte do t'i paraqiten me kohë Komisionit.

2. Shqyrtimi i kërkesës së banjës së Kllokotit dhe të Konfederatës Sindikale

Nerxhivane Dauti – Në cilësi të raportueses vuri në pah se i ka shqyrtuar ankesat. E njoftoi Komisionin me përmbajtjen e tyre dhe ofroi zgjidhje.

E para me kërkesën nr. 142, të datës 16. 06. 2009, të ushtruar nga ndërmarrja shoqërore "Banja e Kllokotit" të Vitisë, theksohet se vendimi i Kuvendit të komunës së Vitisë, lidhur me kalimin e pronësisë së ngastrave shoqërore, nga ndërmarrja shoqërore "Banja e Kllokotit", në pronësi të komunës, është i pabazë.

E dyta me kërkesën nr. 03-2515-D0 1582, të datës 27. 7. 2009, të Federatës së Sindikatave të Lira të Kosovës lidhur me regjistrimin e saj në MSHP.

Komisioni lidhur me dy kërkesat nxori këtë

P e r f u n d i m

1. Komisioni i rekomandon ndërmarrja shoqërore "Banja e Kllokotit" (Viti) ta kërkojë sërish nga institucionet shtetërore përsheptimin e procedurës.
- 2 Komisioni i mbështetur në rregullën 41.2. të Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, vendosi t'ia procedoj Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale kërkesën e Federatës së Sindikatave të Lira.

3 Të ndryshme

(b) Njoftim për takimin e kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit me takimin e kryetarit të Kuvendit dhe me kryetarët e komisioneve se ka debatuar për dinamikën e ligjeve.

Tha se në këtë takim e ka ngritur çështjen e Projektligjit për të pagjeturit dhe ka kërkuar ta dijë në cilën fazë gjendet. Lidhur me këtë diskutuan: Ibrahim Makolli, Sanije Alijaj, Hajredin Hyseni dhe Nerxhivane Dauti.

Radmila Vujoviq – Për identifikimin e mbetjeve mortore, theksoi: *Procesi i identifikimit të mbetjeve mortore është afatgjatë. Në Bosnje ende ka viktime të paignifikuara. Megjithatë duhet të kemi mirëkuptim për nënat, në mënyrë që ato të dëgjohen dhe të shikohet mundësia e realizimit të kërkesave të tyre.*

Komisioni kërkoi nga Qeveria të përshpejtohet procedimit i Projektligjit të të pagjeturve ose të merret nisma për projektimin e tij. Kërkoi të zbatohen pikave të Deklaratës së Kuvendit, si dhe të merren masa për identifikimin e 405 mbetjeve mortore.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 10

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri
